Informacion përmbledhës për skemen dhe procesin e çertifikimit të personave që përdorin pajisje/instalime nën presion

ALCERT sh.p.k është akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit si trupë certifikimi sipas ISO/IEC 17024:2012 për çertifikimin e personave që përdorin pajisje/instalime nën presion.

ALCERT ofron certifikime për persona që përdorin:

1. Kaldaja të projektuara për prodhimin e avullit dhe ujit të nxehte:
2. Enë nën presion të pajisjeve teknologjike dhe rezervuar ajri
3. Rezervuare GLN
4. Enë nën presion kriogjenike
5. Qendrat e mbushjes dhe të depozitimit të bombolave
6. Impiantet e shkarkimit dhe transvazimit të çisternave automobilistike të mallrave të rrezikshme të klasës 2.

Para-kushtet që duhet të plotësoje aplikanti për tu certifikuar:

- Të jetë mbi 18 vjeç - Fotokopje e kartës identitetit/pasaportës ose certifikate lindje origjinale
- Të këtë mbaruar shkollën 8/9 vjeçare ose ka kryer një edukim më të ulet profesional - Fotokopje e dëftesës ose e nje dokumenti te njevlershem me te
- Të këtë një dokument mjekësor që është i aftë për punë

Procesi i aplikimit

Aplikanti dorëzon:

- Kërkesën e firmosur sipas formes se aplikimit tip
- Nënshkrimin e Informacionit Përmbledhës për skemën dhe procesin e certifikimit.
- Dokumentacion qe provon plotësimin e para-kushteve

Procesi i Vlerësimit

Plotësimi i kërkesave vërtetohet nga paravlerësuesi i ALCERT. Nëse aplikanti plotëson kërkesat, ai i nënshtrohet procesit të certifikimit dhe kryen paraprakisht pagesën. Në rast se aplikanti nuk i plotëson kriteret atëherë paravlerësuesi e lajmëron atë për kriteret që ai nuk plotëson dhe procedura e certifikimit nuk fillon.

Nëse kandidati tërhiqet vetë nga procesi i ekzaminimit ai duhet të dërgoj një kërkesë me shkrim të paktën 2 (dy) ditë përpara ekzaminimit. Në këtë rast kandidatit i kthehet 50% e pageses.

Nëse kandidati kërkon që t'i nënshtrohet procesit të ekzaminimit në një datë të mëvonshme ai duhet të njoftojë me shkrim të paktën 4 (katër) ditë përpara ekzaminimit dhe t'i propozojë trupës certifikuese një datë të përafërt.

Në raste të emergjencës, psh sëmundje, raste vdekjeje, kandidati njofton trupën certifikuese dhe paraqet pranë saj në kohën më të afërt dokumenta që vërtetojnë emergjencën.

Aplikanti kandidat i nënshtrohet ekzaminimit për vlerësimin e kompetencës së tij, i cili kryhet në 2 faza: me shkrim, dhe me demonstrim praktik.

Kandidati konsiderohet se kalon me sukses vlerësimin e kompetencës teknike nëse ai merr të paktën 75% të pikëve si në ekzaminimin teorik me shkrim ashtu edhe ne atë praktik. .

Nëse kandidati nuk arrin të marrë me shumë se 75 % të pikëve, i mundësohet një ekzaminim i dytë teorik jo më herët se 7 ditë nga data e ekzaminimit të parë por jo më vonë se pas 6 muajsh.
Ekzaminimi i dytë kryhet njësoj si ekzaminimi i parë. Në rast të mos marrjes së të paktën të 75% të pikëve edhe në ekzaminimin e dytë teorik, kandidatit i hiqet e drejta për vazhdimin e procesit të certifikimit. Në këtë rast kandidati duhet të aplikojë përsëri. Nëse një kandidat aplikon për më shumë fusha mund ti nënshtrohet ekzaminimit në të njëjtën dite me një numër tezash sipas fushave të kërkuara.

Tarifat janë sipas listës së tarifave, të cilat janë të aplikueshme njëlloj për të gjithë kandidatet.

Dëshmia e aftësisë lëshohet me vlefshmëri 5 vjeçare me mbikqyrje çdo vit ne nje nga format e ekzaminimit menyre te alternuar, duke filluar me ekzaminim praktik ne mbikqyrjen e pare, i ndjekur me atë praktikë teorik në vitin e dytë e kështu me rradhe dhe me tarife sa 50% e tarifës së certifikimit fillestar.

Pezullimi dhe Tërheqja e çertifikatës/dëshmisë së aftësisë

ALCERT revokon/pezullon Dëshminë e aftësisë/Çertifikatën në rast se konstaton rrezikimin ose dëmtimin e jetës, shëndetit, të personave apo mjedisit për shkak të personit të certifikuar. Gjithashtu Dëshmia e aftësisë/Çertifikata revokohet/pezullohet edhe në rastet kur përdoret në keqbesim dhe në kundërshtim me funksionet e saj.

Personi i çertifikuar është i detyruar se në rast ndryshimi të gjendjes së tij shëndetësore, e cila ndikon në aftësitë e tij për përmbushjen e detyrës se tij të caktuar si përdorues i një pajisje nën presion, sipas fushës përkatëse, duhet të lajmëroje "ALCERT" brenda një periudhe 2 javore.

Apelimi

Aplikanti, kandidati ose personi i çertifikuar ka të drejtën e apelimit brenda 15 ditësh nga marrja e njoftimit të çdo vendimi nga organizmi çertifikues ALCERT.

Procedura e vlerësimit, hetimit dhe trajtimit të apelimit do të ndiqet sipas procedurës P/9.8/01. Formulari i plotësuar nga apeluesi mund të dërgohet me postë ose me rrugë elektronike nëpërmjet faqes zyrtare të ALCERT.

ALCERT bënë paraprakisht përpjekjet për zgjidhjen me marrëveshje dhe nëse kjo nuk arrihet, çështja kalon te Komisioni i Apelimit i cili merr vendim dhe njofton me shkrim apeluesin brenda 10 ditësh me postë ose rrugë elektronike.

Ankimi

Ankesë është shprehja e pakënaqësisë e ndryshme nga apelimi, nga ana e ndonjë individi ose institucioni për organizmin çertifikues lidhur me aktivitetet e tij ose një personi të çertifikuar prej tij.

Procedurat e ALCERT të trajtimit të ankesave garantojnë trajtimin e të gjitha palëve në mënyrë të drejtë dhe të barabartë në një mënyrë konstruktive, të paanshme dhe në kohë. Ankesa mund të dërgohet me postë ose përmes faqes zyrtare.

Menaxheri i Cilësisë trajton ankesat dhe informon ankuesin për pranimin e ankesës dhe i raporton atij në lidhje me masat që janë marrë.

Vendimi mbi ankesën shqyrtohet dhe miratohet nga Komisioni i Ankesave, i cili merr vendimin përfundimtar dhe njofton me shkrim ankuesin brenda 30 ditësh me postë ose rrugë elektronike, sipas rastit.

Aplikanti: (Emër/Mbiemër)

Firma _____ **ALCERT SH.P.K.**